

Vendimi. nr.02/412 Dt.29/03 /2019

Bazuar në dispozitat e nenit 22 të Rregullores, Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil, dhe në bazë të nenit 39 paragrafi 1, 2, 3, dhe nenit 40 paragrafi 2 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, Këshilli Drejtues në mbledhjen e IV të mbajtur më datën 28.03.2019, mori:

VENDIM

1. Mr.sc. Vaxhid Sadriu, i vazhdohet mandati në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan.
2. Vazhdimi i mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm bëhet për periudhën pesë (5) vjeçare.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm, janë të përcaktuara në nenin 42 të Statutit të Përkohshëm të UKZ-së.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i Universitetit pas shqyrtimit të propozimit të Rektorit të Universitetit për rizgjedhjen e z. Vaxhid Sadriu për Sekretar të Përgjithshëm të UKZ-së dhe pas paraqitjes së vlerësimit të performancës së tij, dhe mbështetur në Opinionin ligjor të Ministrisë së Administratës Publike, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UKZ
2. Këshillit Drejtues
3. Rektorit të UKZ
4. Menaxherit të personelit

Këshilli Drejtues i UKZ


Dr.sc. Emrush Thaçi